

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Jetojmë në një kohë dixhitale! Prandaj, ka gjithnjë e më shumë të ngjarë që numrat t'i shohim të shkruar si numra dhjetorë, jo si thyesa. Për shembull, një parashikues i motit mund të thotë se këtë muaj patëm 2,5 inç shi më shumë se mesatarja, por dihet se e ka fjalën për $2\frac{1}{2}$ inç. Megjithatë, është gjithnjë e rëndësishme të dimë të bëjmë llogaritje me thyesa, sepse shumë probleme të matjeve në jetën reale, sidomos në profesionet e gatimit dhe ndërtimit, përdorin thyesa. Ja dy shembuj:

- Një recetë biskotash me çokolatë kërkon $\frac{3}{4}$ gotë sheqer ngjyrë kafe. Ju doni t'a dyfishoni recetën. Sa sheqer ngjyrë kafe duhet të përdorni?
- Supozoni se keni një rrip dërrasë $36\frac{1}{2}$ inç të gjatë dhe doni të prisni një copë $6\frac{3}{8}$ inç të gjatë. Sa dërrasë ju mbetet?

Gjatë javëve te ardhshme do të mësoni të bëni mbledhje, zbritje, shumëzime dhe pjesëtime me thyesat, si dhe shumëzime dhe pjesëtime me numrat dhjetorë. Me thyesat dhe numrat dhjetorë nuk është e lehtë të punohet, madje shpesh mund të bëhen lloj-lloj gabimesh. Prandaj është e rëndësishme të kontrolloni sa të arsyeshme duken përgjigjet tuaja.

Fjalor Ky kapitull përmban vetëm një term të ri: *numër i anasjelltë*. Numrat e anasjelltë do t'i përdorni kur pjesëtoni thyesat.

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Mund ta ndihmoni nxënësin që të vrasë mendjen ose të punojë me thyesat dhe numrat dhjetorë, siç mund të bjerë rasti dita-ditës:

- Gjeni koston për njësi në dyqanin e ushqimeve (koston e 1 onsi, 1 litri ose 1 cope) për marka ose forma të ndryshme ambalazhimi të të njëjtit produkt, dhe vendosni pastaj se çfarë ju leverdis më shumë të bleni.
- Gjeni sasinë e duhur të përbërësve, kur ju duhet të dyfishoni ose të përgjysmoni një recetë.
- Diskutoni për matjet e ndryshme, metrike ose jo, që bëni kur jeni për shembull duke qepur ose duke punuar me dru.

